

MËKATI I HIJES

Sacili pesë mesh,
Ecti dëri të fundi i rrugës
Nëohshë në përqendrimë ecjet tuesale
Dhe mazi ka meore.


I dhanë pa masë arkivolet
Me shpjet e arret,
Por jo edhe hijen tonë të vritim.
E fyndimarrjes

Kur na bëkon era
Mendimë në jemi të parokshëm
I shkandim të gjithë gjehet
Nga rrethi i umzës

Më postaj
Në frymë e fjalës këtojmë gurin
E mëkati të hijes
Dhe simorët e ngulur nëpër anat tonë



Çmimi 3€



Adem Zaplluzha

MËKATI I HIJES

Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"
Kastriot 2013

Adem Zaplluzha
MËKATI I HIJES

Redaktor:
Dilaver Goxhai:

Recensent:
Dritan Goxhai:

Lektor:
Shpëtim Golemi

PARATHËNIE

Poezitë e shkruara nga Adem Zaplluzha nuk mund të ishin shkruar kurrsesi pa atë perspektivën që vetë historia i dha jetës së tij dhe gjithë popullit tonë pas fitores së lirisë së Kosovës, ndaj dhe poezitë e tij kanë gjithë ndjesinë dhe peshën njerëzore të kësaj ngjarjeje të madhe. Dhe ajo ishte një ngjarje që e mbart veten në lartësinë e historisë e të poezisë. Kjo perspektivë i dha jetë edhe krijimtarisë së Adem Zaplluzhës, i cili ka arritur me nxjerrë nga botimi vëllimin e 82-të poetik të tij. Dhe kjo është shumë e shpjegueshme. Kjo prodhimtari e Adem Zaplluzhës tregon se ai poezinë nuk mund ta lidhë pas asaj që po mbaron e po vdes. “Duhet të dish se si t’i shkulësh bukuritë letrare gjer edhe nga vet gjiri i vdekjes – na thotë Lotrëmoni – por veçse këto bukuri s’do t’i përkasin vdekjes”. Tek poezitë e Zaplluzhës vdekja s’është veçse shkak rastësor.

Duke cituar Lotrëmonin, nuk di pse më shkoi mendimi tek dyshimi se mos vallë Adem Zaplluzha e ka parasysh këtë thënie të tij që edhe në këtë vëllim poetik vdekjen e ka tepër rastësore, madje edhe kur është i detyruar ta përmendi i kundërvë asaj gëzimin e jetës. Këto dy antiteza i shohim dukshëm edhe tek poezia, e cila i ka dhënë titullin

edhe vet këtij vëllimi poetik: “Mëkati i Hijes”, kur thotë:

Secili prej nesh

Ecën deri te fundi i rrugës

Mos vallë na pëlqejnë ecjet funerale

Dhe muzika mortore

Dhe menjëherë i drejtohet erës, sinonimit të jetës, duke thënë:

Kur na bekon era

Mendojmë se jemi të pavdekshëm

I shkundim të gjitha gjethet

Nga rrethi i unazës.

Por, po të lexojmë edhe poezinë tjetër “Dënesim dhe qeshim”, shohim se tek poeti nuk humbasin as kujtesa dhe as vetëdija. Prandaj mund të themi me plot gojën se poeti ynë nuk është nga ata poetë që bëjnë poezi me porosi, por është poet që përjetëson rrethanat dhe momentet jo vetëm ato historike, por edhe një rrethanë sado të vogël. Këtu qëndron edhe sensi poetik i tij. E them këtë pasi poezia e Adem Zaplluzhës buron nga vet ndjenjat e tij me saktësinë e pasqyrit, duke qenë besnik i ngjarjes, duke e transmetuar atë ndjenjë artistikisht tek lexuesi, në shumicën e

poezive në mënyrë metaforike, duke e bërë poezi me vlerë.

Kur poeti thotë:

Nga këtu

Filluan ikjet e zogjve

Nuk di

Nëse ju kujtohet kënga e qyqes

Ishin të gjata rrugët e pikëllimeve

Ai na tregon ngjarjen e kohës së tij, kur nënat me “zogjtë” e tyre në duar (fëmijët) u detyruan të iknin nga Kosova si rrjedhojë e gjenocidit serb, në Marsin e vitit 1999, duke i krahasuar ato me qyqet, zogun e vetmisë.

Më kujtohet

Kur i lamë te pragu gëzimet

Dhe dolëm pa itinerar

Për të marrë botën në sy

Nuk na u desh shumë kohë

Dhe ashtu ndodhi, fillimisht populli ynë iku për të gjetur një strehë, për të futur kokën dhe për të shpëtuar fëmijët, ndaj dhe u duk sikur ishte vetëm duke mbetur në pikëllim, por poeti e konkretizon përsëri kur na thotë:

Ishte Marsi me shi lotësh

Data 27 viti 1999

U gëzoheshim si fëmijë

Zogjve të metaltë

Dhe ecnim binarëve pakufi

Ishin **“zogjtë metalikë”**, (avionët luftarakë të NATO-s), të cilëve populli shqiptar në Kosovë u gëzohej njësoj si fëmijëve të tyre:

Shikonim se si fluturonin

Mbi krahët e duraluminit

Dënesnim e qeshnim

Me gëzimin

Në pikëllimin tonë.

Vetëm sikur me këto dy poezi të kufizohemi në këtë analizë, mund të themi me plot bindjen se Adem Zaplluzha e ka kaluar me kohë periudhën e sprovës. Dhe këtë e shohim te horizonti i poezisë së tij, i cili është zgjeruar mjaft, gjë që tregon se poeti ynë nuk mund të largohet kurrë nga fatkeqësitë e popullit të tij. Ky zë i tij mbizotëron në krijimtarinë e tij poetike, sepse ai përkon me dëshirën e përjetshme të popullit të tij për të jetuar, në kundërshtim me shkatërrimin dhe rrënimin.

Poeti ynë e di se paqja është e vetmia parullë, i vetmi mesazh që ai e përjeton, e vetmia e ardhme e mundshme, prandaj na thotë:

Zjarre këngësh të kënduara

E të pa kënduara

Hipin cikloneve

Dhe zbresin me mjeshtëri

Tej mjegullave

Vijnë

Si shpirtra zgalemash

Dhe udhëtojnë deri në përjetësi. (Poetët)
Tamam për këtë realitet luftoi ai popull. Nuk mund të ketë për Ademin rrethana që nuk janë të lidhura mes tij dhe popullit të tij. Përmes poezive të këtij vëllimi poeti kërkon të na thotë: as zogjtë, as zemrat tona s'kanë për të reshtur ndonjëherë së kënduari për ata që na sollën lirinë.

Ishte koha

Cikli i parë

TOKA E PREMTUAR

Sa herë që njerëzit
Takohen me ndonjë arkivol
Në trungun e shimshirit
Hiqen
Ose shtohen
Copat e pikëllimeve prej mishi

Në disa raste
Ecim nëpër mjegull
Përtej hapave të erës
Dhe në fund të rrugës takohemi
Me ngjyrat e ligështuara
Të ylbereve

Nëse në rrugëtimin tonë
I kapërcejmë dhimbjet e morfologjisë
Nuk di
se çka na mbetet
Përtej sinorëve të shkukur

Sa herë që i biem not detit
Të dalim
Përtej trishtimit të ëndrrave
Ne çdoherë
Do të takohemi me dyndjet e zogjve
Ose kthimin e njerëzve
Në tokën e premtuar

LEGJENDA

Nëse shikojmë asgjësimin e erës
Jemi të gjykuar
Të vendnumërojmë
Deri në vdekje

Asnjë hap
Nuk mund ta tejkaloj
Përrallën e trilluar për një pemë
Me molla të arta
Dikur vonë kuptuam
Se nën atë mollë
Mbiu një Evë

Nga syri i majtë trishtueshëm
Pikonte dita
Kurse në syrin e djathtë
Hynte dhe delte nata

Ne disa herë u mashtruam
Kur e kapërcyem ylberin
Legjenda ishte e rrejshme
Sa që nga shpirti i saj pikonte
Një lloj drite
Që nuk kishte ngjashmëri
Me asnjë parafjalë
E CA TË TJERË

Në ecejaket e mia
Takova disa lloj njerëzish
Disa mbjellin shkurre
E ca të tjerë
Fjalë
Që djegin më shumë se hitrat

Një mik i imi
Pak si më i largët se të tjerët
I përngjan
Qenit të tij të zgërlaqur
I përngjan
Sa që nuk mund t'i dallosh

Kur e përtypin ashtin

Kurse mikësja ime

Si një mace nën sofër

I pret

Dhe i gjuan fjalët

Deri te meteorët me bisht

Kurse një tjetër në lagje

Ka për qejf

T'i imitoi profetët

Me një kërrabë të vjetër

Për çdo ditë

E zgjon kambanën e kujtimeve

KURSE NGA DRITARET

Më duket se diku
Në zbrazëtirën e mendjes
I harruam lutjet
Dhe sërish filluam
Si çdo herë nga e para

Dita ishte e gjatë
I përngjante bishtit të kalit
Te portat e hapura
Dikush për fat
Kishte mbjellë një patkua

Frynte një erë e trullosur
E cila na i përkujtonte psalmet
Por ka kohë
Që kemi harruar të këndojmë

Trokitëm si të çmendur
Në mendjet tona
Asnjë derë nuk hapej
Por nga dritaret me xhama të thyera
Si pa kokë
Dolën ikonat nga kornizat
Dhe kurrë më nuk u kthyen

Prishtinë, 19 shkurt 2013

DËNESIM DHE QESHIM

Nga këtu
Filluan ikjet e zogjve
Nuk di
Nëse ju kujtohet kënga e qyqes
Ishin të gjata rrugët e pikëllimeve

Më kujtohet
Kur i lamë te pragu gëzimet
Dhe dolëm pa itinerar
Për të marrë botën në sy
Nuk na u deshtë shumë kohë

Ishte Marsi me shi lotësh
Data 27 viti 1999
Ne gëzoheshim si fëmijë
Zogjve të metaltë
Dhe ecnim binarëve pakufi

Shikonim se si fluturonin
Mbi krahët e duraluminit
Dënesnim e qeshnim
Me gëzimin
Dhe pikëllimin tonë

ISHTE KOHA

Nuk më kujtohet
A kemi qenë dikur profanë
Ose njerëz me më pak besim
Në ëndrrat e erës

Lutjet e mbrëmjeve
I kemi kënduar të nesërmen
Ose lënë
Për një kohë tjetër

Asnjëherë se lodhnim kokën
Për këto cikërrima të imta
Kishim ca punë të tjera
Ishte koha
E arnimit të lisave

Mbase kemi pas shumë pak kohë
Për të biseduar fshehurazi
Me psalmet e gjetheve
Sa herë që frynin erërat
Thyeshin degët mbi kokat tona

Dimrat kishin një shije tjetër
Ishin të egër
U përngjanin arinjve të murrmë
Sa herë që na dhembte shpirti
Na mësonin se si duhet
T'i lëpijmë plagët

ERA

Këto vite qensh
Nuk di se si kaluan
Nën hijen e plepave
Kuiste nata

Më tutje
Te gëmushat një shtrojerë e thyer
Tok me psalmet e erës
Qante si kërthi

Ne pritëm një kohë të gjatë
Në mesnatë na zgjoi
Zëri i trishtë i një serenate
Te një çati e rrënuar
Dëneste errësira si ullukët e shiut

Kur pushuan të reshurat
Dolën në bejleg kuajt e harlisur

Dikush i shtrëngonte mëgojëzat
Era s'mund të pinte ujë
Në kujtesën e rrapit të lënduar

KY KOR BRETOSASH

Kur nuk patëm
Se kah të ja mbajmë
Ecëm mes zërave të shurdhtë
Të gjetheve

Binarët e trenit
Shtrydhnin ndryshkun
Në shuplakat e plagosura
Te mjegullat
Binte një shtrezë e zezë

Diku te gëmushat
Qante një fëmijë i lënë në harresë
Nënat e harlisura si pelat
Bashkëjetojnë
Me shiringat e trishtimit

Si era e dërmuar
vajton një nuse stërnishtave
Ky kor bretkosash
Nuk ka të ndalur
Sa trishtueshëm sonte

Vajton një qemane
ISHTE E HËNË

Ishte e hënë
Kurse ti nuk i dallon ditët
Ndonëse i përngjan etjes
Ti ke shumë uri

Sa herë që deshe
I zhveshe pemët deri në palcë
Kur të gjithë qanin
Ti këndoje më së miri
Elegjinë e një qemaneje

Kishe një forcë prej titani
Shkëmbin e stralltë e shtrydhje
Si lotin e nuses së virgjër
Dhe këndoje si përherë
Një serenatë prej shiu

Këndoje sa që uleshin zogjtë
Mbi degët e mjegullave
Dhe të dëgjonin syhapur
Deri në mëngjes

Ishte e hënë
Kurse ti me ditët e tua të humbura
U zhduke

Pas atyre të tejpertejmes

TË LUTEM

Të lutem

Mbylli sonte të gjitha dritaret

Këto krakëllima të egra

Zhurmojnë në kokën time

Mbylli edhe portat

Askush nuk duhet të trokas.

Në degët e shthurura të lisave

Sonte kam ethe te verdha

Dua të jem vetëm

Askush përpos vetmisë sime

Nuk mund të qëndrojë pranë muranës

Një sisë pikon nga guri

Dhimbjen e ditës

Të lutem

Mbylli sonte portat e hapura

Dhe dritat që i vizaton ylberi

Mbyll çdo gjë çka mund të mbyllet

Lëre të hapur vetëm mendjen

Le të përgjoi deri në amshim

MËKATI I HIJES

Secili prej nesh
Ecën deri te fundi i rrugës
Ndoshta na pëlqejnë ecjet funerale
Dhe muzika mortore

I duam pa masë arkivolet
Me shijen e arrës
Por jo edhe hijen tonë te vrima
E frymëmarrjes

Kur na bekon era
Mendojmë se jemi të pavdekshëm
I shkundim të gjitha gjethet
Nga rrethi i unazës

Më pastaj
Në frymën e fjalës kërkojmë gurin
E mëkatit të hijes
Dhe sinorët e ngulur nëpër arat tona
KUR ATDHEU

Ne shpeshherë vrapojmë
Nëpër ëndrrat tona
Kur shohim
Se kah na ikin zogjtë

Shndërrohem në flutura të drunjta

Dalim prej përrallave
Dhe zhytemi në mëkatin e gurit
Asnjë shpend grabitqar
Nuk duket në hapësirë

Këto thirrje zogjsh
Pinë ujë në shuplakat e mjegullave
Vonë kuptuam për dyndjen e fluturave
Kur atdheu
Kishte mbetur qyqe në degë

Nga brendia e lisave
Më thirrën arkivolet
Te varret e bardha të nuseve
Hapej dhe mbyllej një legjendë

Kur erdhën dasmorët
Vallja kishte përfunduar diku te prallat
Me disa hije të tejdukshme
Vetëm era lozte në telat e qemanes

QANIN EDHE NUSET

Nëpër syrin e tejdukshëm të shiut
Pikon një hënë e re
Si kuajt e egër të luadheve
Vrapojnë yjet nëpër qiell

Ti ëndërroje në koriye
Sthurjet e baladave
Te rrënjët e një gëmushe
Qante me lot shiu kumria

Freskia trokiste nëpër degë
Asnjë derë nuk hapej
Në lëfytin e drunjtë të kujtesës
Ishin mbyllur të gjitha përrallat

Qante çezma e vjetër
Qanin edhe nuset
Asnjë ushtar nuk erdhi mbrëmë
Nga toka e largët e rërës

KY MERMER I FTOHTË

Një ditë
Të gjithë ne do të mbesim këtu
Do qëndrojmë si statuja në shi
Ky mermer i ftohtë
Do na e ngrijë gjakun

Era do vijë e do shkoi
Kur nëpër flokët e mjegullave
Fshihen shirat
Atë ditë
Pikëllimi i reve do të jetë
Sa një dunë prej dallge

Te moli si çdoherë
Dalin peshkatarët në pritje të anijeve
Kurse detit të pabesë
Nëpër dhomat e errëta të Titanikut
I paraqiten
Gjëmat
E përmytura prej shpirtrave

DËGJOHET NJË GJËMË NËNASH

Njerëzit në fushëbetejë
U përngjajnë perëndive të egër
Si devetë e shkretëtirës
Ecin drejt të pamundurës

Në oazën e shterur
Merimanga e zezë e hap rrjetën
Hingëllimat s'ndalen te rrënjët e kaktusit
Përmes mëgojëzave
Fillon një përmbytje kuajsh

Dielli me ato pak rreze të ftohta
Nuk mund t'i ngroh dizgjinët
Kufomat i kafshojnë arkivolet
Kur hapen dhe mbyllen varret prej dunave

Dikur kah mesdita
Kur tytat e pushkëve i pështynë plumbat
Dëgjohen krakëllima çafkash
Dëgjohen gjëma nënash

FRYNË E FRYNË NJË PUHI NATE

Sa herë që më zë malli
Rend nëpër trishtimin e kujtimeve
Pranë xhadesë

Një breshkë përjeton pikëllimin e diellit

Fryn e fryn një puhi nate
Yjet si qershitë e këputura bien në tokë
Një tjetër hënë
Paska lind sonte në qiell

Ca shporta gjethesh
Mbushen në këtë çast prej dhimbjeve
Kush e ndali mbrëmë serenatën
Kur filloi të frynte një erë?

Fryn e fryn një puhi nate
Yjet rendin kah toka
E njerëzit kah qielli
Fryn e fryn një puhi nate

I SHKUNDËM MOLLËT

Sa herë ia nisëm këngës
E lëmë përgjysmë
Nuk deshëm
Ose nuk ditëm të këndojmë

Ndoshta
Nuk rendëm si duhet
Me hy në histori
Kot e vrapuam maratonën e saj

I shkundëm mollët
Para se të piqeshin degët
Na zuri dimri
Me kërpesh për dore

KAPMA DORËN

Kapma dorën
Nuk po më pëlqen kjo zbrazëtirë
Dita paska etje
Kurse etja trishtim

Kapma dorën
Kur je duke ecur me vetveten
Binarët e trenit nuk takohen askund
E as në qiell

Të lutem ti kapma dorën
Largoje hijen e mallkuar nga kambana
Nuk erdhe dje në këtë mes
Gati dymijë vjet ecim vertikalisht

Më shpëto nga kjo skëterrë
Është koha kur mëshirohen perënditë
Kapma dorën
Të dalim prej kësaj golgote

UNË NUK I BESOJ ERRËSIRËS

Çuditërisht

Paskam mbetur peng mes kësaj poeme.

Si mund të fluturoi flutura

Ngarkuar me arkivol të ngurtë

Nëse hesht lumi

Shpirti ndizet flakë

Unë nuk e pranoj errësirën

Besoj

Sinqerisht besoj

Në mospranimin tuaj

Nëse i ndezim qirinjtë

Nuk di

A mund të ecim vertikalisht

Kjo errësirë po më ngufat

Unë prapë se prapë

Nuk i besoj errësirës

SI TË LEH

Më lidhën ose jam vetëlidhur

Për këtë rrap

I kafshoj zinxhirët

Lëvorja e drurit

Qanë si një kërthi

Nga të katër anët fryn era
Bie një shi lehjesh
Më kanë lidhur për këtë dru
O nëna ime
Më kanë lidhur
Si me qenë i çmendur

Isha fajtor
Nuk munda ta ndalë qenin
Të mos leh
Të mos ua prishte gjumin milicëve
Nëna ime
Të mos ua ngacmonte ëndrrën
Andaj
Më lidhën për këtë dru
Të lehim në duet
O nëna ime
Të lehim
Çfarë të bëjmë

Më ke mësuar ta dua atdheun
Por kurrë nuk më mësove
Se si të leh
Nëna ime
Se si të leh

IK SE TË VRET NATA

Rri nën këtë rrap
Mendoj
Dhe ndjej
Zërin e prushtë të afshit

Te çezma
Nuk erdhën kojrrilat
Përpos fluturave
Askush nuk piu ujë

Ajo erdhi
Piu disa gllënjka
Dhe iku
Sikur të mos kishte qenë kurrë
Te unë mbeti heshtja

Në cicërimën e kësaj nate
Vetëm zëri i mekur i një zogu
Kuiste
Kuiste shpirti im i dërmuar

Prita një kohë të gjatë
Më erdhën zërat e zogjve
Dhe thanë
Ik nga kjo heshtje
Ik se të vret nata

DISA QINDRA VJET

Po zbresim
Tej lumit
Po bien do shira mbi myshqe
Nata diku
I paska ndezur qirinjtë

Sa pak dritë
Në sytë e verbër të sterrës
Atje tej plepave
Mjaullin një mace

Më tutje
Në rrugët e “kafshuara” të fshatit
Kot i lehin qentë hënës
Që rri e bënë sehir

Do pisha të dyllta
Shtrydhnin rrëshirën e ditës
Ne ecim rrugëve të zhveshura
Asnjë pulëbardhë te kiçi i mbijetesës

Dolën shtojzovallet te lisat
Një zë i bekuar i ftoi engjëjt
Disa qindra vjet
Nuk pushuan kambanat

SONTE HËNA

Nëse kalojmë këndeje pari
Rrugët e lagjeve
Do i hapin portat
Kurse psalmet e bardha
Mbi pastelet e mureve
Do çelin ca lule prej lotëve

Nuk do të ketë më
Mbyllje dritaresh
Për udhëtarët e vonuar
Engjëjt i zgjojnë portat e fjetura

Ju lutem
Mos i prekni kornizat e fluturave
Në qiellin e zjarrtë të kujtesës
Sonte hëna
Çel do zogj të kristaltë

Prej këtij vendi
Deri te ëndrrat e tejdukshme
Do bien shirat e prushta
Kur nga kujtesa e rrapeve
Ditët mbinë
Si aguliçet e verdha

Prishtinë, 20 shkurt 2013

*Ky kor bretkosash
Cikli i dytë*

NË SYRIN E KALTËR TË DIELLIT

Si fëmijë
I përngjante Zeusit
Prej qindra lodrave
Zgjodhi vetëm njërën

E donte dhe e rruante
Si kujtesën e gjyshërve
Mbas kurrë nuk ishte fëmijë
Në syrin shqiponjë nuk pat vend loti

Eci përtej guximit
I donte malet si nusen në gjerdek
Në syrin e kaltër të diellit
Ëndërronte dritën

LUFTËTARI

Ia thoshte këngës
Sikur kish kënduar me shekuj
Hynte si fryma e mirë
Mes baladave
Dhe i zgjonte gurët

Ishte i tejdukshëm si ajri
Depërtonte mes gjetheve
Deri në shpirtin e rrapit
Në majat e mjegullave
Zogjve ua ndërtonte çerdhet

Për tu ngjizur me rrënjët
Pinte ujë
Nga damarët e dheut
Duke i shikuar meteorët
Ndriçonte më shumë se yjet

Herë i këndonte këngët
Majë krahut
E herë ia thoshte malësorçe
Kavallin e donte
Më shumë se frymëmarrjen

UNË DO VIJ

Jemi në rrugë
Do i lëmë fjalët peng
Dhe me siguri
Do shihemi kur çelin gjethet

Ju thashë se ika nga zymtësia
Ishte një vend i lagësht
Ku si kërpudhat e verdha
Rritej myku

Një dritare e vockël
Nga e cila pak dritë hynte në dhomë
Që të mos ndryshket
Kova e urinimit

Unë do të vij
Jam në rrugë
Dhe do të eci
Deri te burimi i dritës

Ti më prit
Ashtu siç më prite dyzetë vjet
Ashtu si pritën nënat dhe gjyshet tona
Unë do të vij
Kaherë jam nisur për te ti

AS MISH, AS PESHK

Sa herë jam kthyer
Tek ju
U kam zënë duke fjetur.
Sa mirë do të ishte
T'u përngjanit hënëzave!

Nuk ishit
As mish as peshk
Tanë ditën këndonit
Ndërsa mbrëmjeve
U dëgjoheshin vetëm pordhët

Nëpër hane nuk pushonte lahuta
Për një fjalë goje
Vritej vëllai
E të huajin e nderonit deri në përbuzje

Nën tymin e dehur
Thyheshin gotat për koke
Dhe thahej pastërmaja
E ngrihej dollia
Për vrasësit e vëllezërve

RRËFEJNË PLAKAT

I njoh disa përralla
Të veshura me fustan të kaltër
Në tepe të kresë
Mbanin kryqe dhe gjysmë hëna

Rrëfejnë plakat
Se si ndryshonte moti në çdo kohë
Tregonin për ushtarët e hekurt
Me shpirt prej derri

Si dhe për priftërinjtë e hoxhallarët
Që sa herë ndryshohej moti
I ndërronin çallmat
Dhe veladonët

Por tregojnë edhe për disa burra
Që për zot
Mbanin vetëm pushkën
Dhe hartën e atdheut
Si një gjerdan të shenjtë

KUR KËNDON

Kur ti këndon
Mos harro se kënga e jote
Është një ritual lashtësie
Prandaj mblidhi të gjitha fjalët
Në një trastë të dhirtë

Kur këndon
Mbylli veshtë me dyllë si Uliksi
Dhe le të çmendet deti
Kur hënëzat e kafshojnë anijen
Para se të ankorohet në mol

Kur këndon
Hapi sytë e lëbyrtë të pritjes
Që sa më shumë
Ta dëgjojnë
Kujën e zezë të natës

Kur këndon
Mbylle mendjen me shtatë dry
Dhe vetëm kënga e jote
Le të jetoi
Në brigjet e thyera të kujtesës

ÇELË NJË BALADË

Në këtë kopsht të mëkatit
Rriten vetëm mollët
E mashtrimit.
Kush i pikturoi degët e pikëllimit
Kur në bahçe
Flinte syhapur një Evë

Ti kaloje si një hije
Nëpër tehun e fjalëve
Ku fishkej edhe bari i njomë
Kurse nga degët mëkatare
Pikonin mollët e sherrit

Një Evë që mijëra vjet
Rri e përgjumur
Gjethet e mollëve të egra
Çelin balada
Dhe ngjyrat e pemëve
Orë e çast ndërrojnë

PENGU

Sa herë që era ulej në prehrin e saj
Ajo i krihte flokët.

Një mollë sherri
U këputë nga degët
Dhe u rrokullis
Deri te përralla e Mama Dhisë

I tërë kopshti
I shkundi degët e kujtimeve
Një copë mjegulle
Rrinte varur në qiell

Dita kundronte
Ikjen e fluturave.
Para se të largohej shpresa e fundit
Do zogj fjalësh mbetën peng.

KUR JEMI TË LODHUR

Kur jemi të lodhur
E të mbushur prej pikëllimeve
Bëjmë një dush
Dhe pastaj qëndrojmë lakuriq
Para pasqyrës
Duke i terur flokët në erë
Të habitur
Shikojmë përreth divanit
Mos vallë po na kundron
Ndonjë mushkonjë e mërzitshme

Pa u tharë thinjat e flokëve
I lyejmë
Dhe të pispillosur,
Njësoj si ato të bordellove
Përshëndesim shitësin e gazetave

Kur jemi të lodhur,
Te “Dy plepat”
Si përherë
Rrufisim kafënë farmak
Dhe tërë ditën e ditës
Na merakosin punët e të tjerëve

MEGJITHATË

Sonte
pa dëshirën time
Rri i vetmuar
Te rrapi i kujtimeve
Vetëm gjethet e fishkura
Fëshfërijnë
Një melodi prej mjegulle

Nuk di
A thua është duke fryrë era
Ose po qan lumi
Një zë si i zënë ngushtë
Prej errësirës

I thërret në ndihmë
Hënëzat e Lumëbardhit

Përtej guralecëve jeshilë
Një vashë po luan
Me fustanin e saj
Stërkalat qeshin
E nuk ndalen kurrsesi
Megjithatë diçka po ndodh
Në bregun e kundërt të Drinit të Bardhë

UNË PASH ZOTËRI

Zotërinj,
Nëse nuk ju pëlqejnë gazetat
Lutem
Lexoni në sytë e mi
Trishtimin e kësaj dite

Më besoni
Para 48 orëve
Hëngra një copë bukë të qullur
Binte një shi i zi
Mbi dhëmballët e mia
Që kërcisnin si rrotat
E një qerreje të vjetër

Unë

Zotërinj
Pash
Se si qante xhadeja
Nën trokun e një motori të egër
Qanin edhe lisat
Kurse ju kënaqeshit
Duke dëgjuar në magnetofon
Zërin e shturur të sirenave

Nëse humbin valët
Vendosni veshin në barkun tim
Afrohuni zotërinj afrohuni
Dhe dëgjoni kujdesshëm
Këtë trishtim prej muzike
Të padëgjuar deri më sot

TUBUAR CA NJERËZ

Ma jep atë copë stralli
Dua ta ndez dimrin
Kjo borë
Po m'i mërdhin dhëmbët

Nata alegorike
Në zilet e akullta të krongjijve
I bie fyellit të ngrirë

Diku te një çati e rrënuar
Dëgjohet një vaj
Si cijatje qensh

Nën hijen e një meteori
janë tubuar ca njerëz
Dhe ngrohin shpirtrat e ngrirë
Te një qiriri gati në të sosur

VETVETJA E JONË

Nëse unë
Ndonjëherë
Nuk do të jem unë
Atëherë nuk do të di
Se kush do të jesh ti

Po që se i ndërrojmë vendet
Asnjë prej nesh
Nuk do të jetë më
Vetvetja e vetë

MËRGIMTARI

Në këtë dimër më mjaftojnë
Pak fjalë Njeriu
Dhe një lëvere kuajsh
T'i ngrohi këto eshtra të ngrira

Hape derën moj loke
Edhe nëna ime e thinjur
Diku në atdheun tim
Pret mysafirin e vonuar

Njëqind vjet udhëtova
Deri sa erdha në këtë konak.
Oh sa pak më duhet
Të jem i lumtur sonte

Prishtinë, 21 shkurt 2013

BOSHLLËKU

Po munde
Më prek me gishtat e tua skelet
Jam ajër i pakapshëm
Ose krijesë e tejdukshme
Prapë se prapë
Ka diçka njerëzore te kjo hije

Kur amalgama qesh me mua
Ai atje përballë siluetës
I kreh flokët e dendur të natës
Ti nëse ke durim
Shiko më me kujdes
Hijet që thyhen përtej urës

Përkrah çdo gjëje
që shihet në dukje të parë
Është një mashtrim
Ti mos hezito
Preki me kujdes
Ose futu në sytë e tua të zbrazët
Të pushosh pakëz
Në atë boshllëk të pangopur

NJË COPË TOKE

Sa qenkan holluar këto kërraba
Gati po i përngjajnë
Kashtës së thyer të Kumtrit
Nëpër sa duar kaloj era
Deri sa mbiu
Në majat e lisave

Këto ciflime të ecjeve
Vonë shumë vonë
Paskan mbërrit deri te ju
Nëpërmjet shpërnguljes së erërave
Arkivoli i kujt erdhi mbrëmë
Me aq etje të zhurmshme

Ky shi që po bie pa reshtur
Mbi flokët e mjegullave
Ndoshta nuk dihet
Se nga po vjen
Një copë toke ka ikur nga përralla
Ose bjeshkët lëvizën
Në anën e kundërt të dritës

MË PRITË TË LUTEM

Më pritë të lutem
Dhe shiko se si nga puthja e ime
Çelin disa zogj kristalesh

Këto mjegulla që po largohen
Nuk shkojnë përtej detit
Era sërish i sjell këtu

Më pritë të lutem
Këndeje dynden vetëm njerëzit
Që u përngjajnë ikjes së zogjve

Këto puthje hijesh
Fundosen si çafkat te mjegullat
Dhe ikin premtimet tej hapësirave

MUZIKA

Diku në largësi
Një mal i zhveshur.
Në pragun e dhimbjes së tretë
Trishtueshëm cijatin lisat

Edhe kur ikëm
Trupat tanë i përngjanin shiut
Asnjëherë nuk i shtrimë duart
Për të kapur arkivolet

Kjo mëhallë e evgjitëve
I paska mbyllur qepenat e këngëve
Kaluan shumë kohëra
Që muzika nuk vajtoi këndeje pari

DELTINA

Në udhëkryqet e jetës
Ëndrrën e erës e zë gjumi
Diku në sfond
Lindin imazhet e ylberit

Ti mos kalo kah hijet e plepave
Pa u takuar me gjumin
Se të zë nata
Kur zgjohen kallkanët

Makthet janë diku në rrugë
Dhe saora
të kapin për dore
bijtë e përroit

Në mendimet e poçarit
Disa zogj të hekurt
I vrasin zogjtë që çelin
Njerëz prej dheu

Deltina qau gjatë tërë kohës
Fatin e brishtë
Të tokës gratçore
Asnjëherë nuk e mësuan milingonat

PA TITULL

Me mijëra vjet
Të disa kohërave tis
Te një urë
Ndoshta është edhe mur
Një sisë
I mëkon kujtimet e një legjende

Këtu vijnë hijet e bardha
Edhe ato tis
Për tu mëkuar
Nga ky qumështi i jetës
Te një sisë

Diku
Dikur në një kohë
Te një baladë
si legjendë
Kur thoshin se ishte
Një tjetër botë
Te një lis
Akoma pikon një sisë

QOKTHI

Ku të mbështetem?
Në secilin hap kërcasin eshtrat
Si një araba e palyer

Do eci edhe pak,
Kur të mbërrij në fund
Vendosni një arkivol përballë meje.
Dua që sonte
Të bisedoj me heshtjen

Ju ecni përpara
Tej atyre shkurreve
Ku përherë këndon qokthi
Ndoshta do të jetë kjo
Hera e fundit
E frymëmarrjes së trishtimit.

BOTA NË SHISHE

Të gjitha anët
Ndalen te lumi
Te një shishe e kristaltë
Mbyllur rri gjumi

Një qokth këndon
Atje diku
Askush nuk di se ku
E kah të çon ajo anë

Atje te krongjijtë e akullt ngrihen
Sytë e ariut polar
Kurse një luan
Hungëron në savanë

Diku shkretëtirë pa oazë
Nuk mbin më bar
Bota në shishe
Përjeton çapraz

NJË VASHË ME SYJESHILË

Sa herë kaloj
Nëpër lagjen e romëve
Një rome syjeshile
I ndërron dritat e neonit

Në mendjen time

Herë i kyç sytë
E herë i mbulon
Me flokët e saj prej ere
Nata këndeje kalon
Vetëm një herë në vit
Kur kyçen dritat

Ndoshta ndodhë
Që askush nuk fle në mëhallë.
Një daulle
Si ajo e luftës
I zgjon romët e dehur

Nën epshin e errësirës
Çmendurisht
Lindin
Dhe vdesin
Dashnorët e dehur

NJË NUSE E RE

Nuk di ku isha
Kur kaloi këndeje pari fëmijëria
Një njeri si struci rrinte në shi
I shikonte meteorët me bisht

Kallej një zjarr i paparë
Në baladat e vjetra

Vetëm lahutari
Ua kishte gjetur fillin gjëmave

Në tymin e dendur të hanit
Një pushkë e uritur
Me padurim priste
Që t'i nguli dhëmbët në mish

U këndua edhe një këngë vaji
Gjëmim malesh ushtoi përroi
Një nuse e re
Ditën e tretë të martesës
Mbeti e ve

TË THASHË

Çfarë kërkon sonte
Në fytyrën time
Mos m'i prek rrudhat e ballit
Ato nuk janë të mia

Të lutem mos i lexo dhimbjet
Këtu te ne
Nuk kanë të sosur plagët

Sa herë që ndërruan kohërat
Në trishtimet tona
Ne mbollëm nga një varr

Mbollëm
Nëpër istikame dhe ikëm
Nuk patëm kohë
Për një tufë lule
Dhe një gur vari

Të thashë
Pusho njëherë
Akoma nuk ka ardhur koha
Për leximin e varreve

AMANETI

Më mbani për dore
Ose më afroni te kjo lëndinë
Kur të vijë koha
Dua të kem një varr
Pranë fisit tim

Nuk më pëlqejnë këto këngë
Të kafshuara
Këndomani këngën e Gjergjit
Sa shumë më ka marrë malli
Për hingëllimën e gjokut

Shikoni këtë shpatë
Dhe dizginët e mjegullave

Sa herë që ishte nevoja
Shkreptinte sa shtatë vetëtima

Lutem
Më mbani për dore
Kjo lëndinë pa emër
Dikur ishte me nam
Dua edhe mua
të më varrosni këtu
Me amanetin e lënë
Nga stërgjyshi im

QENI

Thanë se është qeni i lagjes
Por nuk e njoha
Qenka plakur shumë
Kush e di
Se sa vite qensh
Paskan kaluar
Mbi kurrizin e kësaj nate

Ullukët disi
Qëndrojnë në heshtje
Dhe paskajshëm të mrrolur
Pikon e pikon trishtimi
Nëpër kujtesën e rrugëve
Qeni i moshuar

E paska harruar edhe lehjen

Mbrëmë

Thanë se kishte ikur diku

Askush nuk dinte se ku

Por kjo ikje

Po i përngjan misterit

E kujt qenka kjo lëkurë

E mbetur te ky mur

*Një fustan prej letre
Cikli i tretë*

MARSI

Le të jenë të hapura dyert

Do të vij një ditë

Mos i mbyllni as mendimet

Se në të kundërt

Shndërroheni në harresë

Tani është dimër

Udhëtimet fillojnë në pranverë

Gjithmonë marsi ka qenë i tillë

Zgjohet herët

Dhe nuk fle tërë stinën

Ju lërin të hapura portat

Pranvera shumë shpejtë vjen
Atë ditë zgjohen gjethet
Ne përherë jemi endur
Prej pranvere në pranverë

LUMI

Nesër është ditë e hënë
Nëse nuk mund të më gjeni
Mes fjalëve të mjegullave
Më kërkoni
Në hingëllimën e kuajve

Mos trokitni në asnjë derë
Edhe ashtu
Njerëzit më nuk i hapin portat
Shiu i mbrëmshëm
Ishte i tëri me rrebesh

Shih
Se si e paskan ndarë qytetin
Një pjesë e gjysmës së lumit
Shkon tërmal
Kurse tjetra tatëpjetë
Kur do të pushojnë
Këto çmenduri ndarjesh

Prishtinë, 22 shkurt

PATA EDHE DITË MË TË MIRA

Këto duar presin shiun
Që rrinë varur te retë
Ndoshta presin edhe dikë
Ose diçka
që kurrë nuk do të vijë

Presin ashtu siç prita kot
Atë copë mjegulle
Mbi kujtimet e vetëtimave

Pata edhe ditë më të mira
Kur nga gjelbërimi
Mbinin të tjera frymëzime
Që ua shtonin afshin poezive

Ishte koha e pritjeve
Koha kur njerëzit ecnin duke qeshur
Tej brishtësisë së saj

Pata edhe ditë të tjera
Ecja vertikale
I përngjante rrapeve të lagjes
Ku flinin kumritë
Nëpër çerdhe pritjesh

NATA ËSHTË E GJATË

Nga këto ethe
Po teshtijnë reshjet
Çfarë të bëj me gjumin tim
Kur nuk më lë të fle

Nata është e gjatë
Zgjatet si ulërimë bishash
Ku ta vë kokën e lodhur
Në gjumin e kujt të hy

Nata qenka e gjatë
Nuk paska të sosur
Në përrallën e kujt të fshihem
Me këto makthe të çmendura

Nata është e gjatë
Nga sytë e mi pikojnë lodhjet
Ku t'i pushojë këto eshtra
Ku të fle pak si njeri

KURSE NETËT QANIN

Unë bashkëjetova
Ose më drejtë
Jetova njëqind vjet

Me hijen e balsamosur

Herë frynte një erë e çmendur
E herë tufani i dalldisur
Ditët trembeshin nga të papriturat
Kurse netët ishin të frikshme

Binte një shi i zi
I ngarkuar me trishtime lotësh
Kur qante një fëmijë
Edhe lumi pranë shatërvanit dëneste

Ndalu i thash erës
Furtuna fryu edhe më shumë
Nga koka ime e lodhur
Fluturoi edhe shpresa e fundit

Rrugët mbuloheshin me shqotë
Kurse netët qanin
Një grumbull patash të egra
Braktisnin kënetën e pikëllimit

ME LOT MALLËNGJIMI

Rri e shikoj orën e vjetër
Që rri varur në stacion
Një zog shtegtar
Posa doli nga çerdhja e trishtimit

Thashë vet me vete
Filluan fluturimet
Po largohet diku
Edhe djaloshi i fundit i lagjes

Një vashë te një pemë
End një shami të përlotur
Këlthasin degët e thyera të shpirtit
Me lot mallëngjimi
Gulçon dhe bari i pranverës

EMRI

Ne të gjithë
Kemi nga dy emra
Njërin na e thonë në vesh
Kurse tjetrin
Në librat e lindjeve

Çuditërisht
Atë të veshit e fshehim
Xhelozish e ruajmë për kohën tjetër
Kurse këtë të regjistrave
Shpesh herë na e përflasin

Emri im i mirë
Dhe ai i fshehuri në kujtesë

Përherë rrinë zgjuar
Dhe syhapur
Pa iu tremb askujt
Presin maratonën finale

MBUSHE NJË GJYM

Mbushe një shishe me fjalë
Dhe hidhe tej shkëmbit
Ashtu
Siç i hidhnim dikur
Guralecët shpatuk
Mbi valëvitjen e dallgëve

Nëse nuk e hapin njerëzit
Domosdo një ditë
Dhe njëherë
Do e hap deti
Si zarfet e kaltër
Që i hapnin ushtarët
Nëpër istikame

Mbushe edhe një gjym
Me verën e vreshtave të fshatit
Kur të na marrë malli
Për zogjtë shtegtarë
Do e pimë
Për shëndetin e atdheut

POETËT

Shumë e shumë zjarre
Të dukshmit
E të padukshmit
Nuk shihen kurrë
Herë si flaka e qiriut
E herë si një flakadan
Ndizen në shpirtrat e poetëve

Zjarre këngësh të kënduara
E të pa kënduara
Hipin cikloneve
Dhe zbresin me mjeshtëri
Tej mjegullave
Vijnë
Si shpirtra zgalemash
Dhe udhëtojnë deri në përjetësi

TË THASHË

Të thashë
Se një ditë do të takohemi aty
Ku lindi ndarja

Po qe se ngjan ndryshe
Ti rri te pemët
Dhe më prit si gjithmonë

Era do të kaloi fshehurazi
Nëpër kujtesë
Deri sa të gjethoi në mendimet e tua

Të thashë
Por ti s'u duke askund
Si mund të jetosh brenda vetvetes?

DETI

Ky deti yt i paanë
A thua ka vdekur
Apo vdekja i sillet rreth e rrotull
Si shakullinë prej bore

Diçka po ndodhë me ty
Në xhepat e kujt i harrove fjalët
Çfarë janë këto duar

Që u përngjajnë përqaftimeve të metalta

Sa shumë po i bien
E sa pak dëgjohet
Kjo daulle e shurdhët e erës
Një kavall në kujtesë po vdes si deti

Ti më prit atje
Ku me duart tona e vramë vetveten
Këtë det të madh të trishtimit
Po e përpin kjo grykë e erës

EDHE NJË HERË AQ VETA

Ndoshta nuk i kujtohet askujt
Që kufomën time prej ere
E morri uji
Dhe nuk u duk më kurrë

Qe disa vjet me radhë
Vdesim nga dy
Ose tri herë në ditë

Pash edhe më keq
Në një anije fantazmë
Ngarkuar me kufoma
Për së gjalli
Më kishin vendosur si dekor

Diku në ballë të furtunës
Isha pre
E dasmës së hënëzave
Dhe deri në mëngjes
Më kafshuan
Të pabesët
Kur dolëm në breg
Asnjë arkivol i gjallë
Nuk ecte mbi këmbët e veta

U duhej dy
Ose katër e më shumë njerëz
Për copëtimin e dërrasave
Ndoshta
Edhe njëherë aq veta
Me nga dy dhëmb
Në kokë

ATA

Nën hijen e një molle
Ajo zonjë loz
Me thonjtë e saj artificialë
Si flutura e larme
Me telat e kitarës

Kurse Ai

Si kalë i Harlisur
I kashais mustakët në erë
Dhe fundoset
Në ngjyrat e degëve

PRANVERA

Porsa hedh shallin pranvera
Shoh se si dimri
Ikën pa kokë
Përtej maleve

Mbi dallgët xheloze të liqenit
Tok me peshqit
Luajnë dhe njerëzit
Tangon e përjetësisë

Një fëshfërimë gjethesh
Zhaurin në veshin e lisit
Paskan dalë zogjtë
Te Molla e Kuqe

ME NJË FUSTAN PREJ LETRE

Ajo kishte një fustan prej letre
Kalonte trotuareve
Si peri
Më duket se madhështinë e ecjes
E kishte huazuar nga era

Sa herë që i krihte flokët
I tundte
Gjymtyrët e ajrit
Herë i përngjante kukullave
E herë tërbohej
Si gurgullima e përroit

Ajo kalonte mbi shiringat
E përdorura
Dhe qeshte
Me të lehurat e qenve prapa krahëve

Syzeza flokë verdhë
Me një fustan të bardhë
Prej letre
Ecte e ecte
Tatëpjetës së përçartë

GËRTHITJA

Sot herët në mëngjes

U zgjova
Me disa imazhe heronjsh
Tej ëndrrës kacafytëshin
Ca statuja të mermerta

Një sfinks i gjunjëzuar
Te dunat e rërave
Fërshëllente
Melodinë e lashtë të oazës

Mes kolonadave
Kanë dalë mbretërit e çmendur
Dhe gjysmë të zhveshur
Shëtisin
Nëpër tej pamësinë e luksit

Fryn një erë prej flame
Tunden
Shpatullat e rrapit plak

Kollitet e gërthet
Ky mal i vjetër
Nga një sëmundje e rëndë
I pështynë mushkëritë
Si gjethet e zverdhura

HERËN E TETË

Afër bredhave të rrëshirta
Dëgjohen britma djajsh
Përzier
Me ca sharje banale

Njëqind herë në ditë
Lëshohen
Në gjysmë shtize
Flamujt e turpit

Këtu koha gënjen
Më shumë se shitësit e pelave
Në vend të atit
Për pak lek
Shitet gomari

Shtatë herë në ditë
Te pishat e Deçanit
E zbresin hyjin nga fronti
Dhe herën e tetë
Shiten
Kinse janë profet

QENI

Sa i mirë
Ky qen i gërmadhve
Me gjasa ka sy njeriu
Nëse fundosesh në to
Mund të notosh deri në amshim

Si një foshnje
Të shikon njerëzishëm
Sa herë që i lëviz këmbët
Të përcjell me brishtësi
Tej mase
I pëlqen gëzofi yt prej dhelpre

Ky qen i gërmadhve
Aspak
Nuk i përngjan njeriut
Po kalove kah stela te muranat
Të përcjell
Me një pamje prej fëmije

Prishtinë, 23 shkurt 2013

Biografia

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 01. 02
1943.

Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë.

Një kohë punoi mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957

Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të penës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi u botua përmbledhja "Ngjyra e Kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një sërë krijimesh letrare nëpër gazeta dhe revista, që dalin në Prishtinë, Shkup dhe Zagreb. Në vitin 2010 i përkthehet një libër në gjuhën Rumune, nga përkthyesi i mirënjohur Baki Ymeri, "Pema e Bekuar", libër, i cili u mirëprit nga lexuesi Rumun.

Po atë vit, në një nga numrat e revistës "Shqiptari",

në Rumani, në bashkëpunim me redaksinë revistës “Dituria”, në Boras të Suedisë, botohet një antologji, “Jehona e Shekujve”, autor Sokol Demaku, ku përfshihen edhe disa punime të Adem Zaplluzhës.

Është prezantuar në LEKSIKONIN SHKRIMTARËVE SHQIPTARË 1501-1990, Nga Hasan Hasani, si dhe në LEKSIKONIN SHKRIMTARËT SHQIPTARË PËR FËMIJË, 1872- 1995 Nga Odhise K. Grillo, dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behlul, Prishtinë 2002.

Si dhe është përfaqësuar në Rumuni në një antologji të shkrimtarëve të Kosovës nga Monica Marushan KOSOVA LITERARA, (Kosova letrare, përkthyer nga Baki Ymeri, alias Alban Voka .2011

Është anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.**
2. **“Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.**
3. **“Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.**
4. **“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.**

5. **“Morfologjia e dhembjes”**, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”**, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. **“Letër nga mërgimi”**, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëdarja”**, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. **“Thirrje e gjakut”**, poezi,“Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”**, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”**, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. **“Puthja e gozhduar”**, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. **“Kashelasha në vargje”**, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. **“Pema e bekuar”**, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. **“Bajraktarët e vatanit”**, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”**, poezi,“Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
- 18.**”Stuhi në Kutulishte”**, poezi,“Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.

19. **“Posa ikte nata”**, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
20. **“Loja e myshqeve”**, poezi,“Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **“Lumëbardhi dhe gjëma”**, poezi,“Qendra e kulturës”,Kastriot, 2010
22. **“Metafora e heshtjes”**, poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2010
23. **“Hyji në Prekaz”**, poezi,“Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **“Sinorët e hinores”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **“Don Kishoti dhe Rosinanti”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26.**“Zjarri i dashurisë”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **“Kur likenet vallëzojnë”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. **“Ditari në vargje”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2010.
30. **“Shtegu i mallit”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31. **“Korniza e thyer”**”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010

34. **"Merre kodin"**, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot, 2011
35. **"Letër atdheut"** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **"Tejdukshmëria e shiut"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
37. **"Përtej teje"**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **"Sa afër e sa larg"** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **"Vallja e zanoreve"**, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
40. **"Ikja e eshtrave"**, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
41. **"Kalorësit e mjegullave"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **"Hingëllimat e shiut"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **"Kur pemët i ndërrojnë këmishët"**. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
44. **"Mirëmëngjes Imzot"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2012
45. **"Kafshimi i mikut"**, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **"Atje tej maleve"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. **"Heshtja që del në shesh,"** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2012

48. **“Portat e shpresës”**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
50. **“Kinse Lojë Shahu”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
52. **“Fusha e mëllenjave”**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
53. **“E kujt është kjo vetmi”**, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. **“ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. **“Urori i stralltë”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2012
57. **“Po të mos ishte fjala”**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2012
58. **“Thyerja e urave”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2012
59. **“ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
60. **“ Në flokët e dëborës”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. **“Një grusht nostalgji”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
64. **“Lisi në rrënjët e veta”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2012
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
66. **“Fëmijët e erës”**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“Çast në fund të stinës”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69. **“Më pëlqejnë mendimet e tua”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. **“Andej dhe këndej kohës”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. **“Zëri i heshtjes”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
72. **“Kush i lexoi letrat prej erës”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73. **“Fluturimi i korbave në netët pa hënë”**, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75. **“Diku te një baladë”**, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. **“Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
- 77 **“Ky def prej hëne”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“Fahri Fazliu-Kastriot, 2012

- 78 .“ **Pyesni zogjtë në ikje**”,Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79. “ **Fërfërimë gjethesh** “ Poezi, shtëpia,botuese-Kastriot, 2013
- 80 . “ **Refrene yjesh**”, Poezi, shtëpia botuese “ Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
81. “**Te delta e mjellmave**”, **Poezi, shtëpia botuese “ Fahri Fazliu”- Kastriot ,**
- 82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
- 83.“**Diku në fund të një fillimi**”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
- 84.“ **Një zog prej uji**”, Poezi, shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2013
- 85.“**Mëkati i hijes**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2013

PËRMBAJTJA

Ishte koha	
Cikli i parë	11
Toka e premtuar.....	13
Legjenda.....	14
E ca të tjerë.....	15
Kurse nga dritaret.....	16
Dënesim dhe qeshim.....	17
Ishte koha.....	18
Era.....	20
Ky kor bretkosash.....	21
Ishte e hënë.....	22
Të lutem.....	23
Mëkat i hijes.....	24
Kur atdheu.....	25
Qanin edhe nuset.....	26
Ky mermer i ftohtë.....	27
Dëgjohet një gjëmë nënash.....	28
Fryn e fryn një puhi nate.....	29
I shkundëm mollët.....	30
Kapma dorën.....	31
Unë nuk i besoj errësirës.....	32
Si të leh.....	33
Ik se të vret nata.....	35
Disa qindra vjet.....	36
Sonte hëna.....	37

Ky kor bretkosash	
Cikli i dytë.....	39
Në syrin e kaltër të diellit.....	41
Luftëtari.....	42
Unë do vij.....	43
As mish as peshk.....	44
Rrëfejnë plakat.....	45
Kur këndon.....	46
Çelë një baladë.....	47
Pengu.....	48
Kur jemi të lodhur.....	49
Megjithatë.....	50
Unë pashë zotëri.....	51
Tubuar ca njerëz.....	53
Vetvetja e jonë	54
Mërgimtari.....	55
Boshllëku	56
Një copë toke.....	57
Më pritë të lutem.....	58
Muzika	59
Deltina.....	60
Pa titull.....	61
Qokthi.....	62
Bota në shishe.....	63
Një vashë me syjeshilë.....	64
Një nuse e re.....	65
Të thashë.....	66
Amaneti.....	67
Qeni.....	68

Një fustan prej letre	
Cikli i tretë.....	69
Marsi.....	71
Lumi.....	72
Pata edhe ditë më të mira.....	73
Nata ishte e gjatë.....	74
Kurse netët qanin.....	75
Me lot mallëngjimi.....	76
Emri.....	77
Mbushe një gjym.....	78
Poetët	79
Të thashë.....	80
Deti.....	81
Edhe një herë aq veta.....	82
Ata.....	84
Pranvera.....	85
Me një fustan prej letre.....	86
Gërthitja.....	87
Herën e tretë.....	88
Qeni.....	89

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Mëkat i hijes/ Adem Zaplluzha. - Kastriot :
Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, 2013. - 102 f. ;
21 cm.

Parathënie : f. 5-9. – Biografia : f. 90-91

ISBN 978-9951-538-97-8

